BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 14, datë 20.02.2017

Për
"MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMIT "FONDI I KOMUNITETEVE", HARTUAR SIPAS UDHËZUESIT OPERACIONAL PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT "FONDI I KOMUNITETEVE""

Mbështetur në nenin 8, pika 2, neni 9, pika 1/I, shkronja "a" dhe "b", neni 23, pikat 4, 5 dhe 9; neni 54, shkronjat "dh" dhe "k"; neni 55 pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 45, datë 06.07.2016 për "Ngritjen e Task Forcë-s për regjistrimin e asambleve të bashkëpronësisë dhe administratorëve të bashkëpronësisë; nenin 40, pika 3 të Ligjit nr. 10112, datë 9.4.2009 për "Administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit"; nenet 209-221 të Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar); nenin 50 të Ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 për "Regjistrimin e pasurive të paluajtshme (i ndryshuar); nenet 6, 7 dhe 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 për "Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" (i ndryshuar); Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 447, datë 16.06.2010 për "Miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit";; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1011, datë 10.12.2010 për "Miratimin e formatit tip të aktit të bashkëpronësisë"; Udhëzimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit nr. 27, datë 20.12.2010 për "Llogaritjen e tarifës së administrimit për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin dhe zbatimin e Programit "Fondi i Komuniteteve", me qëllim nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe asamblesë së bashkëpronarëve sipas Udhëzuesit Operacional për Programin "Fondi i Komuniteteve", bashkëlidhur këtij vendimi si Shtojca Nr. 1.

2. Efektet financiare të pikës 1 të këtij Vendimi do të përballohen nga zëri "Shpenzime Operative", Art. 602, Aparati i Bashkisë, në programin e Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit, të parashikuar në Buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2017.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Finaciar, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria e Zhvillimit të Marrëdhënieve me Komunitetin dhe Njësitë Administrative dhe Kryetari i Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

ANEKS NR. 1

BASHKIA E TIRANËS

Programi “Fondi i Komuniteteve”

(Udhëzues operacional)

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrje 5
1.1. Informacion i përgjithshëm 5
1.2. Qëllimi kryesor i Programit 5
1.3. Objektivat Specifike 5
1.4. Problemet kryesore të hasura dhe që synohet të trajtohen 6
2. Elementet kyç 6
2.1. Aplikantët e pranueshëm 6
2.2. Shuma e fondit 6
2.3. Llojet e projekteve të kualifikueshme për bashkëfinancim 7
2.4. Mbulimi gjeografik 7
3. Udhëzuesi për zbatimin 7
3.1. Hapat paraprake 7
3.2. Procesi i Aplikimit 8
3.3. Vlerësimi dhe përzgjedhja e fituesve të fondit 9
3.4. Kontraktimi dhe Përdorimi i Fondeve 10
3.5. Monitorimi dhe Vlerësimi 12
3.6. Rezultatet e pritshme 13
4. Rregullore e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve të Fondit të Komuniteteve 13
4.1. Krijimi i Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve dhe Anëtaret 13
4.2. Thirrja e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve 14
4.3. Vlerësimi i aplikativë për dhënien e fondit. 14
5. Rregullore për Komisionin e Monitorimit të Fondit të Komuniteteve 15
5.1. Krijimi, Anëtaret dhe Thirrja e Komisionit 15
5.2. Detyrat e Komisionit 15
Anekset 16
Aneksi 1 –Formular Aplikimi 16
Aneks 2 - Formulari i Vlerësimit për Aplikimin në Fondin e Komuniteteve 19
Aneksi 3 – Procesverbali për Vlerësimin e Aplikimeve 21
Aneksi 4 – Listë kontrolli e Dokumenteve të Dorëzuara të Aplikimit për Fondin 21
Aneksi 5 – Njoftim për përzgjedhjen e fituesit të Aplikimit 22
Aneks 6 - Raporti për Përdorimin e Fondit 23
Aneks 7 – Deklaratë dakortësie mes bashkëpronarëve 24

1. Hyrje

1.1. Informacion i përgjithshëm

Programi i "Fondit i Komuniteteve" synon të nxisë bashkëpunimin efektiv në mesin e qytetarëve për përmirësimin e infrastrukturës së blloqeve të banimit dhe ruajtjen e ambienteve në pronësi të përbashkët. Nëpërmjet një skeme Fondesh të vëna në dispozicion nga Bashkia e Tiranës banorët e lagjeve të ndryshme (bashkëpronarët e ambjenteve të banimit) të kryeqytetit mund të organizohen sëbashku nën udhëheqjen e Administratorëve për të përfituar bashkë-financim për projekte infrastrukturore të cilat adresojnë një problem të caktuar në komunitetin e tyre. Nëpërmjet këtij programi synohen të arrihen një sërë objektivash të cilat nuk kanë të bëjnë vetëm me përmirësimin e ambjenteve të përbashkëta por gjithashtu synojnë ndryshimin e mentalitetit të bashkëpunimit mes qytetarëve dhe institucioneve publike.

Ky program përbën një mundësi mjaft të mirë për ta kthyer qytetarin në pjesë thelbësorë të procesit vendimmarrës kundrejt nevojave personale dhe atyre të komunitetit. Gjithashtu programi kontribuon në ndërgjegjësimin e tij duke i dhënë më shumë përgjegjësi në menaxhimin e fondeve dhe në mirëmbajtjen e ambjenteve të përbashkëta.

Skema e funksionimit të këtij programi do të rregullohet dhe orientohet kryesisht nga ligjet dhe VKM-të kryesore që prekin fushën e bashkëpronësisë dhe menaxhimit të fondeve të përbashkëta të tilla si: Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", Ligji 10 112 (2009) "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit", VKM 447 (2010) Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit, VKM 408 Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, Ligji 139 (2015) Për Vetëqeverisjen vendore etj.

Me ligjin e 2009 mbi administrimin e bashkëpronësisë tashmë Bashkive u është dhënë e drejta për të nxitur dhe mbështetur komunitetet në administrimin e mjediseve të përbashkëta. Deri më tani ky ligj nuk është aplikuar ende në shkallë të gjërë prandaj dhe mjaft banorë të kryeqytetit mund të mos jenë në dijeni të detyrimeve të reja që ata kanë tashmë me ligj. Për këtë arsye, ky program synon gjithashtu të nxisë nisjen e zbatimit konkret të ligjit më qëllim për të ndikuar pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet dhe në përgjithësi përmirësimin e hapësirës urbane.

1.2. Qëllimi kryesor i Programit

Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe Bashkisë së Tiranës duke krijuar një skemë efektive bashkë-financimi me qëllim përmirësimin e ambienteve në pronësi të përbashkët të komuniteteve.

1.3. Objektivat Specifike

- Mbështetja financiare e komuniteteve që kanë nevojë dhe dëshirë për të përmirësuar ambjentet e tyre të përbashkëta.

- Përmirësimi i infrastrukturës dhe hapësirave urbane të kryeqytetit.
- Nxitja e përfshirjes dhe pjesmarrjes aktive në çështjet që kanë të bëjnë me mirë-funksionimin e bashkëjetesës në komunitet
- Nxitja e bashkëpunimit pozitiv midis komuniteteve dhe qeverisë lokale.
- Mbështetja e iniciativave komunitare të qytetarëve me qëllim nxitjen dhe kultivimin e mentalitetit të bashkëpunimit.
- Edukimi qytetar për mbrojtjen e ambienteve të përbashkëta dhe mirëpërdorimin e financave të tyre.
- Përshpejtimi i procedurave për punësimin dhe rregjistrimin e Administratorëve të Pallateve.

1.4. Problemet kryesore të hasura dhe që synohen të trajtohen

- Burime financiare të kufizuara të komuniteteve por edhe të pushtetit vendor për realizimin e mjaft ndërhyrjeve për të cilat ka nevojë në Bashkia Tiranë
- Ndërgjegjësim i ulët qytetar për mbarëvajtjen e pronës së përbashkët
- Mungesa e bashkëpunimit qytetar në lidhje me përmirësimin e bashkëjetesës në komunitet.
- Mungesa e njohurisë mbi kuadrin ligjor përkatës.
- Kapacitete të limituara vendore për mirëmbajtjen e banesave apo blloqeve të banimit

2. Elementet kyç

2.1. Aplikantët e pranueshëm

Administratorët[1]/Shoqëritë administruese në emër të Asambleve dhe në bashkëpunim me anëtarët e kryesive, me shkrim aplikojnë në bashki me një **Formular Aplikimi (Aneks 1)** dhe dokumentet përkatëse i dorëzojnë në zyrat e Njësive Administrative. Administratori aplikues duhet të jetë person fizik, i përfshirë në librin e administratorëve, të mbajtur nga Bashkia, për të ushtruar veprimtari në fushën e administrimit të ndërtesave, ose sipas parashikimeve të ligjit nr.10112 "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit". Shoqëria administruese aplikuese duhet të jetë person juridik privat, po ashtu e përfshirë në librin e administratorëve të mbajtur nga bashkia, për të ushtruar veprimtari në fushën e administrimit të ndërtesave, ose parashikimeve të ligjit nr.10112 "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimi. Në rastin kur projekti parashikon të zbatohet në një objekt bashkëpronësie, aplikimi kryhet nga Administratori i këtij objekti. Në rastin kur projekti parashikohet të përfshijë disa objekte bashkëpronësie, ose një hapësirë në funksion të disa objekteve bashkëpronësie, aplikimi kryhet nga të gjithë administratorët e këtyre objektve, ose nga njëri prej tyre i autorizuar me prokurë të posaçme.

2.2. Shuma e fondit

1 Në këtë dokument, termi administrator i referohet edhe shoqërive të administrimit, dhe anasjelltas, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

Shuma totale e fondit e parashikuar për vitin 2017 është 20.000.000 lekë. Kjo shumë parashikohet të shpërndahet në disa projekte bashkëfinancimi, të cilat do të përzgjidhen përmes thirrjeve për aplikim çdo muaj duke filluar nga Marsi i vitit 2017. Fondi limit i aplikimit do të jetë 2.000.000 lekë .

Një nga kriteret e dhënies së fondit është kriteri i bashkëfinancimit. Bashkëfinancimi duhet të jetë i masës minimalisht 50% e fondit total (fondi total= fondi i BT + fondi i mbledhur nga bashkëpronarët).

2.3. Llojet e projekteve të kualifikueshme për bashkëfinancim

1. Mirëmbajtje Fasadash: Këtu përfshihen lyerje dhe suvatim fasadash, etj. (Neni 6, VKM 408)
2. Punimet për eliminimin e barrierave arkitektonike dhe përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara (Neni 7, VKM 408)
3. Projekte ruajtje/eficence energjie apo impakt pozitiv mjedisor: Këtu përfshihet termoizolimi i fasadave, vendosja e paneleve diellore, etj. (neni 7, VKM 408)
4. Mirëmbajtje Taracash: Këtu përfshihet punime hidroizolimi dhe termoizolimi të taracave, etj. (neni 7, VKM 408)
5. Mirëmbajtje e shesheve (hapësirave publike dhe/ose në bashkëpronësi në funksion të blloqeve të banimit, këndeve të lojërave dhe fushave sportive ekzistuese). Këtu përfshihen: rehabilitim i shtresave të shesheve (pllaka trotuaresh, riparim asfalti apo shtresash të ndryshme), mbjellje bari/shkurresh/pemësh dekorative, instalime stolash/ hapësirash pushimi, vijëzim vendparkimesh dhe sinjalistike brenda bllokut të banimit, riparime të ndriçimit publik ekzistues, etj. (neni 7, VKM 408

Të gjitha llojet e mësipërme të ndërhyrjeve nuk bëjnë pjesë në kategoritë e punimeve të cilat kërkojnë leje zhvillimore. Në rastet e ndërhyrjeve të parashikuara në pikën 1, punimet kryhen pa pajisjen me leje ndërtimi dhe pa deklaratë paraprake punimesh, sipas Nenit 6 të VKM nr. 408 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, ndërsa për ndërhyrjet e parashikuara në pikat 2-5 mjafton kryerja e deklaratës paraprake të punimeve, nga ana e aplikuesve të shpallur fitues të fondit, sipas nenit 7 të VKM nr. 408 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

2.4. Mbulimi gjeografik

Ky fond parashikon financimin e projekteve të cilat zbatohen brenda territorit administrativ të Bashkisë Tiranë.

3. Udhëzuesi për zbatimin

3.1. Hapat paraprake

1. Krijohet “Fondi për Mbështetjen e Komuniteteve” prej 20,000,000 lekësh, për vitin 2017, në buxhetin e Bashkisë në funksion të projekteve të bashkëfinancuara me banorët e lagjeve.

2. Kryerja e një fushate fillestare informuese mbi programin, qëllimin e tij dhe mënyrën e funksionimit. Komunikohet fondi i disponueshëm dhe nisin thirrjet e përmuajshme për aplikime. Përhapja e informacionit do të bëhet nëpërmjet:
   a. Ëebsite/Social Media
   b. Mediat tradicionale
   c. Shpallje në Zyrat e Njesive Administrative
   d. Takime me qytetarët në Njësitë Administrative dhe me administratorët e regjistruar në librin e administratorëve.
3. Nxitja nga Bashkia për krijimin e asambleve të bashkëpronarëve, regjistrimin e kryesive të asambleve si dhe e administratorëve/shoqërive administruese në Regjistrin e bashkëpronësisë dhe Regjistrin e Administratorëve përkatësisht. Nxitje për hapjen e një llogarie bankare për çdo asamble bashkëpronarësh.
4. Në fillim të çdo muaji Bashkia e Tiranës do të shpallë thirrje për aplikim për fondin, duke filluar nga muaji Mars 2017. Me Urdhër të Krytetarit të Bashkisë, do të ngrihet Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve. Të interesuarit do të mund të aplikojnë gjatë 3 javëve të para të çdo muaji, ndërkohë që java e katërt i rezervohet Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve për përzgjedhjen e fituesit të secilit fond.

Regjistrimi i kryesive të asambleve dhe administratorëve/shoqërive administruese në regjistrat përkatës pranë Bashkisë Tiranë me konsolidimin e praktikave të administrimit të bashkëpronësisë do vazhdojnë të funksionojnë si procedura të detyrueshme me ligj (Neni 13 i Ligjit 10112 Për administrimin e bashkëpronesisë) pavaresisht nëse banoret perfitojnë apo jo nga ky program.

3.2. Procesi i Aplikimit

1. Administratorët në emër të Asambleve ose në bashkëpunim me anëtarët e kryesive, me shkrim aplikojnë në bashki me një **Formular Aplikimi (Aneks 1)** dhe dokumentat përkatëse i dorëzojnë në zyrat e njësive administrative. Në rastin kur projekti parashikon të zbatohet në një objekt bashkëpronësie, aplikimi kryhet nga Administratori i këtij objekti. Në rastin kur projekti parashikohet të përfshijë disa objekte bashkëpronësie, ose një hapësirë në funksion të disa objekteve bashkëpronësie, aplikimi kryhet nga të gjithë administratorët e këtyre objektve, ose nga njëri prej tyre i autorizuar me prokurë të posaçme. Prokura dorëzohet si pjesë e dokumentacionit të aplikimit.
2. Për ndërhyrjet e tipit 1, 2, 3 dhe 4, të pikës 2.3, të cilat parashikohet të kryhen në hapësirën e ndërtesës që është objekt bashkëpronësie, duhet të shoqërohen me një dokument dakortësie mes bashkëpronarëve, ku minimalisht duhet të garantohet dakortësia e 51% e kuotave të pjesëmarrjes në bashkëpronësi, ose sipas parashikimeve të ligjit nr.10 112 (2009) **(Aneks 7).**

3. Aplikuesit, të përfaqësuar nga Administratori i tyre, hartojnë një projekt paraprak së bashku me një preventiv paraprak punimesh dhe një plan pune paraprak duke u asistuar, atëherë kur është e nevojshme, nga zyra e urbanistikës pranë secilës Njësi Administrative përkatëse. Në rast se Aplikuesit kanë një projekt zbatimi të gatshëm së bashku me preventivin përfundimtar, kjo do t'i favorizojë në përzgjedhje.

3.3. Vlerësimi dhe përzgjedhja e fituesve të fondit

1. Me Urdhër të Kryetarit do të bëhet ngritja e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve prej 7 anëtarësh që do të zgjedhë fituesit e fondit si dhe do të sigurohet që projektet e predispozuara për të qenë fituese të jenë në përputhje me planet e Bashkisë.

a. Ky komision do të përbëhet nga 1 ose 2 anëtarë nga drejtoritë në vijim (i) Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik; (ii) Drejtorisë së Përgjithshme e Menaxhimit Financiar; (iii) Drejtorisë e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit; (iv) Drejtorisë së Përgjithshme e Punëve Publike (v) Drejtorisë së Përgjithshme nr.2 e Punëtorëve të Qytetit; (vi) Drejtoria e Zhvillimit të Marrëdhënieve me Komunitetin dhe Njësitë Administrative.

2. Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve përzgjedh fituesit në bazë të një sistemi pikëzimi të bazuar në kriteret e meposhtme:

a. Kriteri ekonomik –
   i. Sa më i madh të jete kontributi financiar i siguruar nga bashkëpronaret aq me shume pike merr propozimi
   ii. Projektet e propozuara qe kontribuojnë me shume se 50% të fondit total të projektit fitojnë më shumë pikë
   iii. Përdorimi eficent i fondit: Projekti duhet të përdorë sa më mirë fondin e bashkisë dhe kontributin e qytetarëve (Me shume shpenzime kapitale sesa operative

b. Kriteri i nevojës –
   i. Projektet të cilët konsiderohen emergjente
   ii. Projekte të cilat plotësojnë një nevoje thelbësore për komunitetin

c. Kriteri i Projekteve Prioritare (sipas nenit 40 të ligjit nr 10112 "Për Administrimin e Bashkëpronësisë në Ndërtesat e Banimit):
   i. Zona/Projekte Prioritare, sipas PPV-së, dhe dokumentave të zhvillimit strategjik të tjerë
   ii. Projekte të cilat kanë të bëjnë me ruajtjen/eficencën e energjisë apo kanë impakt pozitiv mjedisor
   iii. Fasadat janë anash rrugëve kryesore apo janë në gjëndje tejet të dëmtuar

d. Kriteri Inovativ / Kreativ
   i. Projektet të cilat sjellin inovacion ne ndërhyrjet e tyre duke ofruar zgjidhje të reja për probleme të caktuara komunitare

ii. Projekte të tjera kreative të cilat kontribuar pozitivisht ne bashkejetesen e komunitetit si dhe ne imazhin e kryeqytetit

3. Shpallja e fituesit dhe kërkesa për dokumenta dhe të dhëna shtesë

a. Secili anëtar i Komisionit Vlerësues të Aplikimeve plotëson **Formularin e Vlerësimit për Aplikimin në Fondin e Komuniteteve (Aneks 2)**

b. Numri i aplikuesve të shpallur fitues çdo muaj përcaktohet me vendim te Komisionit Vlerësues të Aplikimeve. Komisioni mund të vendosë të shpallë fitues më shumë se një aplikues, gjithmonë duke nisur përzgjedhjen nga projektet që janë renditur më të suksesshmit mbi bazë të pikëve të mbledhura. Komisioni duhet të sigurohet që projektet fituese i përmbushin të gjitha kriteret Administrative, sipas pikës 4.3/a të këtij dokumenti. Numri i projekteve fituese të shpallura çdo muaj vendoset nga komisioni, për të siguruar që i gjithë fondi prej 20.000.000 lekësh ezaurohet gjatë vitit 2017, siç është parashikuar.

3.4. Kontraktimi dhe Përdorimi i Fondeve

1. Shpallja e fituesit të secilës thirrje bëhet në faqen ëeb të Bashkisë Tiranë si dhe i komunikohet aplikuesit në kontaktin e vënë në dispozicion prej tij në formularin e aplikimit.
2. Me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë ngrihet Komisioni i Monitorimit të Fondit të Komuniteteve për secilën thirrje.
3. Fituesve u kërkohet, që brenda muajit të parë pas shpalljes së tyre si fitues të Fondit, të ndjekin hapat e mëposhtëm:

a. Mbledhja e kontributit nga të gjithë qytetarët dhe depozitimi i tij në një llogari bankare të hapur në emër të Administratorit apo Asamblesë së bashkëpronarëve. Këtu do duhet të sigurohen dokumentat bankare te llogarise dhe shumës së ngrirë në llogari dhe duhet t'i dorëzohen Komisionit të Monitorimit.

b. Bashkëpunim i ngushtë me zyrat e urbanistikës së Njësive Administrative përkatëse, për hartimin e Projektit të zbatimit. Projekti i zbatimit, së bashku me preventivin përfundimtar dhe planin e punës përfundimtar hartohet nga specialistët e urbanistikës së Njësive Administrative ku ndodhet projekti fitues, dhe i dorëzohet për miratim Drejtorisë së Përgjithsme të Planifikimit të Territorit si dhe miratohen në këshill teknik. Një kopje të projektit të miratuar e mban Komisioni i Monitorimit.

c. Për projektet që do të zbatohen në objekte bashkëpronësie aplikuesi duhet të dorëzoj edhe një kopje të certifikatës së pronësisë.

4. Miratimi i projekti të detajuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike bëhet brenda një afati dy javor nga dorëzimi i tij.
5. Duke qënë se kategoria e ndërhyreve të lejuara në projektet e aplikantëve (Sipas pikës 2.3 të këtij dokumenti) konsistojnë kryesisht në punime mirëmbajtje, hartohet deklarata paraprake e zhvillimit të punimeve, siç parashikohen në VKM 408 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit". Dokumentacioni i nevojshëm për kryerjen e punimeve me deklaratë

paraprake përcaktohet imtësisht në Nenin 8 të VKM 408 - Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit.

6. Lidhet kontrata nëpërmjet 2 palëve → Administratorit të komunitetit fitues të fondit + Bashkisë Tiranë.
7. Depozitohen ofertat e kompanive të cilat kanë konkurruar për të ofruar punimet infrastrukturore të nevojshme për realizimin e projektit të miratuar si dhe kompanive furnitore (ne rastet kur furnizimi me materiale nuk behet nga kompania qe realizon punimet). Ofertat duhet të jenë paraqitur nga të paktën 3 kompani. Në këtë dokument aplikuesit duhet të arsyetojnë zgjedhjen e kompanisë përkatëse si ajo me ofertën më të mirë krahasuar me cilësinë duke justifikuar kështu edhe koston e punimeve. Ofertat dhe përzgjedhja e kompanisë përkatëse i dorëzohet Komisionit të Monitorimit
8. Zbatimi i projektit të përzgjedhur:

a. Fituesit do të zbatojnë çdo fazë të projektit të zbatimit të hartuar specialistët e zyrës së urbanistikës pranë Njësive Administrative përkatëse dhe të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike.
b. Monitorimi i punimeve do të kryhet nga një Komision Monitorimi i posaçëm i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Tiranë.

9. Shlyerja e fondit:

a. Bashkia dhe bashkëpronarët konsiderohen si bashkëfinancues të projektit, në raportin 50% Bashkia – minimumi 50% komuniteti. Shlyerja e fondit do të bëhet në dy faza maksimalisht:

i. Pas përfundimit të 50% të kostos totale të projektit, administratori depoziton pranë Bashkisë Tiranë faturat për realizimin e shpenzimeve dhe Raportin për Përdorimin e Fondit **(Aneks 6).** Raporti për Përdorimin e Fondit duhet të jetë i firmosur nga anëtarët e Komisionit të Monitorimit. Në këtë fazë Bashkia shlyen 50% të fondit të saj, që përbën maksimalisht 25% të kostos së gjithë projektit. Pjesa tjetër e shpenzimeve të kryera këtë fazë mbulohet nga fondi i mbledhur nga bashkëpronarët.
ii. Pas përfundimit total të projektit, sërish administratori depoziton pranë Bashkisë Tiranë faturat për realizimin e shpenzimeve dhe Raportin për Përdorimin e Fondit **(Aneks 6).** Në këtë fazë Bashkia shlyen edhe 50% e mbetur të fondit.
iii. Administratori mund të vendosë të kërkojë shlyerjen e fondit vetëm në përfundim të projektit, duke dorëzuar të gjitha faturat dhe Raportin për Përdorimin e Fondit njëhërësh. Në këtë rast Bashkia shlyen 100% të fondit të alokuar prej saj, në fund të projektit.

b. Pagesat ndaj furnitorëve dhe kompanisë që do kryejë punimet do të bëhen nga Administratori i komunitetit përfitues dhe bashkisë do u paraqiten si provë faturat e shpenzimeve, ku me dorëzimin e tyre do të bëhet edhe likuidimi i fondeve siç është

përcaktuar më sipër në pikën a. Të gjithë këto procedura do të jenë të përcaktuara në kontratën që do të lidhet mes të treja palëve duke përcaktuar përgjegjësitë e secilës palë.

10. Të gjitha transaksionet financiare të projektit për çështje sigurie maksimale do të kryhen përmes Bankës. Në përfundim të gjithë projektit dhe shlyerjes totale të fondit, duhet që Bashkia të disponojë 1 kopje të gjithë dokumentacionit të projektit, që do të mbahet nga Komisioni i Monitorimit deri në përfundim të projektit, si dhe 1 kopje duhet ta mbajë administratori.

3.5. Monitorimi dhe Vlerësimi

Komisioni i Monitorimit bën inspektime periodike në terren, për tu siguruar për mbarëvajtjen e zbatimit të projektit. Gjatë inspektimeve të kryera komisioni mban proces verbale, të cilat i depoziton në dosjen ku mbahet dokumentacioni i plotë i projektit. Në përfundim të projektit, komisioni harton një raport dhe e publikon sëbashku me dokumentacionin përkatës, në përputhje me parimin e transparencës për të gjithe qytetarët por në vecanti për asamblenë e bashkëpronarëve të projektit përkatës.

Pas suksesit të disa prej projekteve mund të krijohet tek ëebsite i Bashkisë një hartë online e cila do të përmbajë informacionin mbi projektet e realizuara deri më tani.

Cikli i zbatimit të programit

3.6. Rezultatet e pritshme

1. Angazhim gjithmonë e më i lartë qytetar për zgjidhjen e problemeve që prekin cilësinë e bashkëjetesës në komunitet
2. Qytetarë më të ndërgjegjësuar në lidhje me mbarëvajtjen e pronës dhe të mirës së përbashkët duke dhënë secili kontributin që i takon.
3. Hapësira urbane të përmirësuara.
4. Bashkëjetesë më e organizuar dhe cilësore në komunitet (jo vetëm në rastin e aplikimit për projekte specifike por edhe në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të përditshme)
5. Futja e një fryme të re të bashkëpunimiit e cila do të ndikojë gjërësisht edhe në edukimin me të njëjten ftymë të brezave të rinj.
6. Zbatueshmëri më e lartë e Ligjit të Administrimit të bashkëpronësisë.

4. Rregullore e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve të Fondit të Komuniteteve

4.1. Krijimi i Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve dhe Anëtaret

Komisioni për dhënien e fondeve do të krijohet me anë të një Urdhri të Kryetarit të Bashkisë.

Ky komision do të përbehet nga 7 anëtare përfaqësues të këtyre drejtorive:

- Drejtoria e Përgjithshme nr. 2 e Punëtoreve të Qytetit
- Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike
- Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik

- Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar
- Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit
- Drejtoria e Zhvillimit të Marrëdhënieve me Komunitetin dhe Njësitë Administrative.

4.2. Thirrja e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve

Takimet e Komisionit do të organizohen në ambientet e Bashkisë së Tiranës. Në takimin e parë, Komisioni vendos kryetarin e tij.

Së Pari, anëtarët e Komisionit do të mblidhen për të vlerësuar secilin aplikim për përmbushjen e kritereve minimale administrative për shpalljen e vlefshmërisë së aplikimit, sipas pikës 4.3/a.

Së dyti, Komisioni do të shqyrtojë aplikimet që përmbushin kriteret administrative dhe do të vendosë pikët për secilin projekt propozim sipas kritereve të përcaktuara në pikën 4.3/b.

Së fundi, Komisioni rendit projekt propozimet sipas pikëve përfundimtare për secilin (mesatarja e pikëve individuale të dhëna nga secili anëtar).

Të gjithë anëtarët e Komisionit duhet të bien dakord me rezultatet përfundimtare.

Kryetari i Komisionit vepron dhe si sekretar gjatë takimeve dhe harton procesverbalin e takimeve.

4.3. Vlerësimi i aplikativë për dhënien e fondit.

a) Kriteret Administrative

- Formulari i aplikimit të jetë plotësuar në mënyrë të plotë dhe të saktë
- Marrëveshja bashke me firmat e bashkëpronarëve që përbëjnë e të paktën 51% e kuotave të bashkëpronësisë ku përcaktohet konsensusi për zhvillimin e punimeve ne pronën e përbashkët bashke me deklaratën për buxhetin e ofruar prej tyre.
- Buxheti i ofruar nga bashkëpronaret nuk duhet të jete me pak se 50% e shumës totale të projektit të propozuar.

Në rast se njëri nga kriteret e mësipërme nuk përmbushet, aplikuesi skualifikohet nga gara e atij muaji dhe ftohet të aplikojë muajin e ardhshëm me dokumentacionin e plotësuar.

b) Kriteret dhe sistemi i pikëve

Kriteri	Piket	Përcaktimi i pikëve
Kriteri Ekonomik	30 pike	- Kontributi i bashkëpronarëve: Sa me i madhe të jete kontributi i siguruar nga bashkëpronaret aq me shume pike merr propozimi - Përdorimi eficent i fondit:

		Projekti duhet të përdorë sa më mirë fondin e bashkisë dhe kontributin e qytetarëve
Kriteri i Nevojës	30 pike	Projektet të cilët konsiderohen prioritare ose me të nevojshme për pallatin/bllokun përkatës marrin me shume pike se projektet e tjera
Faktorët Prioritarë	30 pike	Zona/Projekte Prioritare, sipas PPV-së, dhe dokumenteve të zhvillimit strategjik të tjerë Projekte të cilat kanë të bëjnë me ruajtjen/eficencën e energjisë apo kanë impakt pozitiv mjedisor Fasadat janë anash rrugëve kryesore apo janë në gjendje tejet të dëmtuar Në rast se ka aplikime nga zonat periferike, ato do të shihen me prioritet Projekt lehtësisht i zbatueshëm nga komuniteti
Kriteri Inovativ / Kreativ	10	Projektet të cilat sjellin inovacion dhe kreativitet ne ndërhyrjet e tyre duke kontribuar pozitivisht ne bashkëjetesën e komunitetit si dhe ne imazhin e kryeqytetit do të kenë gjithashtu prioritet.

5. Rregullore për Komisionin e Monitorimit të Fondit të Komuniteteve

5.1. Krijimi, Anëtaret dhe Thirrja e Komisionit

Komisioni për monitorimin e shpenzimit të fondeve dhe zhvillimit të punimeve në kuadër të Programit të Fondit të Komuniteteve do të krijohet me anë të një Urdhri të Kryetarit të Bashkisë. Ky komision do të përbehet nga 4 anëtare. Nga këto, një përfaqësues do të jetë nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, një përfaqësues nga njësia administrative ku po zbatohet projekti, një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit, si dhe një përfaqësues nga institucionet e varësisë sipas llojit të punimeve në fjalë.

5.2. Detyrat e Komisionit

Së Pari, anëtarët e Komisionit do të mbajnë të gjithë dokumentacionin përkatës të fituesve të fondit. Këtu përfshihen: (i) Aplikimi së bashku me dokumentacionin dhe anekset përkatëse; (ii) Projektin Final të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike; (iii) Deklaratën paraprake për kryerjen e punimeve sipas VKM nr.408 “Për zhvillimin e territorit” në rast se do të

nevojitet; (iv) Një kopje të kontratës trepalëshe të lidhur ndërmjet Administratorit, Bashkisë së Tiranës dhe Firmës së kontraktuar; (v) Proces Verbalet e mbajtura gjatë inspektimeve në terren; (vi) Dokumenta të tjerë të cilësuar në këtë material, ose të evidentuara gjatë hartimit/zbatimit të projektit sipas nevojës.

Së dyti, Komisioni do të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme punimet dhe mbarëvajtjen e përgjithshme të projektit fitues si dhe do të mbajë Proces verbalet e inspektimeve monitoruese në terren për ecurinë e punimeve. Minimalisht komisioni duhet të kryejë dy inspektime: inspektimi i parë pas përfundimit të punimeve në masën 50%-70% dhe inspektimi i dytë në përfundim të projektit të plotë. Inspektimet e tjera janë opsionale, por të domosdoshme për të garantuar mbarëvajtjen e procesit.

Së treti, me përfundimin e punimeve Komisioni do të firmosë së bashku me Administratorin Raportin mbi Përdorimin Përfundimtar të Fondit, një kopje e të cilit do të përfshihet në dosjen e dokumentacionit të mbajtur nga ky komision.

Së fundmi, komisioni ngarkohet me detyrën për të zhvilluar një raport përfundimtar monitorimi i cili do te pasqyrojë gjithë mbarëvajtjen financiare dhe finalizimin e punimeve të projektit.

Anekset

Aneksi 1 –Formular Aplikimi

Aplikim për përfitim Fondi

Programi "Fondi i Komuniteteve"

Kujdes

- *Aplikantët duhet të sigurohen që i kanë lexuar me kujdes rregullat e aplikimit të përcaktuara në program si dhe të jenë të regjistruar në Regjistrin e Administratorëve të Bashkisë Tiranë.*
- *Nëse ju duhet ndihmë për plotësimin e këtij formulari, ju lutem drejtohuni tek zyrat e njësisë administrative përkatëse.*
- *Aplikantët duhet të sigurojnë informacion sa më të plotë dhe të detajuar të projektit që do të propozojnë. Aplikimet duhet të plotësohen vetëm në formë elektronike. Aplikimet e plotësuara me dorë nuk do të pranohen.*

1. Informacion mbi administratorin

Emri dhe Mbiemri i Administratorit	
Adresa e objektit nën administrim për të cillin po bëhet aplikimi	
Numri i telefonit/cel.	
E-mail	

Adresa personale e Administratorit	

2. Informacion mbi komunitetin e interesuar:

2.a Qytetarët që kërkojnë ndërhyrjen e shprehur në këtë aplikim janë pjesë e:

** Një pallati të vetëm* ** Një blloku pallatesh*

2.b Nëse qytetarët janë pjesë e një blloku pallatesh:

- *Blloku i pallateve administrohet veç nga 1 Administrator (përgjegjës për ketë aplikim)*
- *Çdo pallat ka administratorin e vet por unë jam i autorizuar të aplikoj në emër të tyre (bashkengjitur prokura e posaçme).*
- *Tjetër (Shpjegoni)*

.....
.....

3. Cila është adresa e saktë e vendit ku propozohet ndërhyrja? *(Ju lutemi jepni detaje duke specifikuar: Njësinë Administrative/Lagjen ku ndodhen objekti i ndërhyrjes si dhe adresën e saktë).*

.....
.....

4. Jepni një përshkrim të përgjithshëm të problemit të evidentuar

.....
.....

5. Cili është projekt propozimi juaj për zgjidhjen e problemit

.....
.....

6. Afërsisht sa kohë është parashikuar të nevojitet për kryerjen e gjithë ndërhyrjeve *(Nga nisja e punimeve e deri në përfundimin e tyre).*

.....
.....

7. Sa është parashikuar afërsisht të jetë fondi total i nevojshëm për kryerjen e ndërhyrjeve? Çfarë elementësh keni llogaritur në parashikimin tuaj? *(*Kujdes: këtu duhen specifikuar të gjitha shpenzimet e mundshme që mund të hasen gjatë gjithë fazës së zbatimit të projektit, kostot e kryerjes së punimeve, etj.,)*

.....
.....

8. Sa është shuma totale e mbledhur nga komuniteti juaj për këtë projekt?

……

……

9. Sa është shuma totale e nevojshme e kontributit që kërkoni nga Bashkia e Tiranës për projektin?

……

……

5. Sa është numri total i bashkëpronarëve të objektit/vendit ku do të bëhen ndërhyrjet?

……

……

6. Sa prej bashkëpronarëve janë dakord me ndërhyrjen?

……

……

10. Nëse ka bashkëpronarë të cilët nuk janë dakord për zhvillimin e ndërhyrjeve jepni arsyet kryesore të kundërshtimit të tyre.

……

……

……

11. A ekzistojnë çështje ligjore të pa-përfunduara lidhur me pronësinë e objektit/hapësirës ku do të bëhen ndërhyrjet të cilat mund të pengojnë apo krijojnë problem në zhvillimin e projektit?

……

……

……

AFATI PËR DORËZIMIN E APLIKIMIT

Aplikimet duhet të dorëzohen brënda javës së tretë kalendarike të çdo muaji. Në faqen ëeb të Bashkisë Tiranë si dhe në Ambjentet e Njësive Administrative do të afishohen njoftimet mujore me datat përfundimtare të dorëzimit për secilin fond mujor.

12. Ju lutemi aplikimit tuaj t'i bashkëngjisni:

- *Hartën e evidentuar të hapësirës ku nevojitet të bëhet ndërhyrja e propozuar në këtë formular. (pranohen ortofoto, google earth apo lloje të tjera hartash të cilat ndihmojnë në evidentimin e objektit të cilit i referohet aplikimi).*
- *Projektin paraprak, preventivin paraprak dhe planin e punës paraprak.*
- *3 foto te objektit/hapësirës ku parashikohet të zhvillohet projekti..*
- *Një akt-marrëveshje të firmosur nga bashkëpronarët ku ata bien dakord për ndërhyrjen e kërkuar përmes këtij aplikimi si dhe detyrimin e tyre financiar. (Aneks 7)*
- *Prokurë të posaçme nëse njëri administrator po aplikon në emër të disa administratorëve.*

Deklaratë

Unë, i nënshkruari, vërtetoj që zotëroj autorizimin për të paraqitur këtë aplikim në emër të bashkëpronarëve që përbëjnë mbi 51% të kuotave të bashkëpronësisë të objektit/objekteve të prekura nga ky projekt.

Firma **Data**

Aneks 2 - **Formulari i Vlerësimit për Aplikimin në Fondin e Komuniteteve**

Aplikanti (Emri i Administratorit): .....

Nr. Identifikues i aplikimit: .....

Komuniteti i përfaqësuar është pjesë e:

☐ Një Pallati ☐ Një Blloku Pallatesh

	Si të bëni matjen	**Pikët përfundimtare**
Kriteri Ekonomik	Sa me i madh të jete kontributi financiar i siguruar nga bashkëpronaret aq me shume pike merr propozimi (Maks. 10 pike)	
	Projektet e propozuara qe kontribuojnë me shume se 50% të fondit total të projektit (Maks. 10 pike)	
	Përdorimi eficent i fondit: Projekti duhet të përdorë sa më mirë fondin e bashkisë dhe kontributin e qytetarëve (Me shume shpenzime kapitale sesa operative). (Maks. 10 pike)	
Pikët jo përfundimtare të Grupit I (Maks. 30)		
	Si të bëni matjen	**Pikët përfundimtare**
Kriteri i Nevojës	Projektet të cilët konsiderohen emergjente (Maks. 15 pike) (5 deri ne 15 pike në bazë të nivelit të emergjencës ku: 15 pike = niveli maksimal i emergjencës dhe 5 pike = niveli më i ulët i emergjencës)	
	Projekte të cilat plotësojnë një nevoje thelbësore për komunitetin (5 deri ne 15 pike ku: 15 pike = nevojë thelbësore dhe 5 pike = e nevojshme)	
Pikët jo përfundimtare të Grupit II (Maks.. 30)		
	Si të bëni matjen	**Pikët përfundimtare**
Kriteri I Projekteve Prioritare	Zona/Projekte Prioritare, sipas PPV-së, dhe dokumenteve të zhvillimit strategjik të tjerë (Maks. 10 pike)	
	Projekte të cilat kanë të bëjnë me ruajtjen/eficencën e energjisë apo kanë impakt pozitiv mjedisor (Maks. 10 pike)	

	Fasadat janë anash rrugëve kryesore apo janë në gjendje tejet të dëmtuar (Maks. 10 pike)	
Pikët jo përfundimtare të Grupit III (Maks. 30)		
	Si të bëni matjen	**Pikët përfundimtare**
Kriteri Inovativ & Kreativ	Projektet të cilat sjellin inovacion ne ndërhyrjet e tyre duke ofruar zgjidhje të reja për probleme të caktuara komunitare (Maks. 5 pike)	
	Projekte të tjera kreative të cilat kontribuar pozitivisht ne bashkejetesen e komunitetit si dhe ne imazhin e kryeqytetit (Maks. 5 pike)	
Pikët jo përfundimtare të Grupit IV (Maks. 10)		
TOTALI (Maks. 100 Pike)		

Vlerësuesi: .....

Firma: .....

Data: .....

Aneksi 3 – Procesverbali për Vlerësimin e Aplikimeve

Më..... (data) Komisioni i Vlerësimi u mblodh dhe shqyrtoi …… (numri) aplikime, të ardhura deri ..... (ora) më ..... (data),

Gjatë shqyrtimit të aplikimeve, Aplikimet e mëposhtme rezultuan të papranueshëm në kuadër të Projektit për Fondin e Komuniteteve nga Bashkia e Tiranës dhe si përfundim nuk u pranuan:

Nr.	Numri i aplikimit	Arsyet e mospranimit

Në bazë të kritereve për vlerësim, aplikimet e mbetura u vlerësuan si më poshtë:

Nr.	Numri i aplikimit	Pikët totale

Nga sa më sipër, komisioni vendosi të shpallë fitues aplikantët e mëposhtëm për këtë thirrje:

Nr.	Numri i aplikimit	Pikët totale	Vendimi përfundimtar

Falënderojmë të gjithë aplikantët pjesëmarrës në Projekt dhe ju ftojmë që të aplikoni sërish në të ardhmen.

Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit:

1. ..... 2. ..... 3. .....

4. ..... 5. ..... 6. .....

7. .....

Aneksi 4 – Listë kontrolli e Dokumenteve të Dorëzuara të Aplikimit për Fondin

Listë kontrolli e Dokumenteve të Dorëzuara të Aplikimit për Fondin

Aplikanti: ……

Nr. Identifikues i Aplikantit: .....

Data: ……

Verifikimi i plotësisë së dokumenteve:

Lloji i dokumentit	Po	Jo	Shënime
1. Aplikimi i plotësuar dhe i firmosur	☐	☐	
2. Deklarata e bashkëpronarëve për dakordësinë e zhvillimit të projektit dhe shumës së akorduar	☐	☐	
3. Projekt - idenë për ndërhyrjet së bashku me një preventiv paraprak të gjithë kostove kapitale dhe operative dhe plan pune paraprak	☐	☐	
4. 1 deri në 3 foto të objektit/hapësirës ku parashikohet të zhvillohet projekti..	☐	☐	
5. Hartën e evidentuar të hapësirës ku nevojitet të bëhet ndërhyrja e propozuar në këtë formular.	☐	☐	
6. Të tjera, specifiko: _____ _____ _____	☐	☐	

Përfaqësuesi i Njësisë Administrative: Aplikanti:

....

Aneksi 5 – Njoftim për përzgjedhjen e fituesit të Aplikimit

Njoftim për Aplikantët

Protokoll Dalje. ...../2017 Data.....2017

I nderuar Z./Znj. .....,

* Kemi kënaqësinë t'iu informojmë se aplikimi që keni dorëzuar për të përfituar nga Programi i Bashkisë së Tiranës për Fondin e Komuniteteve ka qenë i suksesshëm dhe do të financohet me një fond prej ……. LEK

Ju urojmë shumë suksese në realizimin e projektit për komunitetin tuaj.

Ju lutemi kontaktoni Njësinë Bashkiake përkatëse për hapat që do të ndiqen në vijim.

** Me keqardhje ju informojmë se aplikimi që keni dorëzuar në Programin e Bashkisë së Tiranës për Fondin e Komuniteteve nuk arriti totalin e pikëve të nevojshme për t'u konsideruar fitues, dhe si rrjedhojë nuk jeni pranuar për të marrë Fondin për projektin tuaj. Ju ftojmë të aplikoni

sërish në shpalljet e muajve në vijim. Jeni të mirëpritur pranë Njësisë Bashkiakë përkatëse për tu konsultuar për mënyrën si mund të përmirësohet aplikimi juaj.

Komisioni e bazoi vlerësimin e aplikimeve në bazë te kritereve të mëposhtme:
1) Kriteri ekonomik – Projektet të cilat kanë vlefshmëri më të lartë ekonomike kundrejt kostos, përdorin në mënyrë më eficent fondin dhe ku kontributi i banorëve me fonde ka qenë me i lartë.
2) Kriteri i nevojës – Projektet të cilat konsiderohen me prioritet të lartë për banorët apo janë të nevojshme për adresimin e një problemi të vazhdueshëm në pallatin/bllokun përkatës.
3) Kriteri i prioritetit urban – Projektet të cilat ndikojnë pozitivisht në përmirësimin apo zhvillimin urban të qytetit.
4) Kriteri Inovativ – Projekte të cilat sjellin inovacion dhe kreativitet me zhvillimin e tyre duke ndikuar pozitivisht në bashkëjetesën e komunitetit të prekur.

Aplikimi juaj u vlerësua me ……/30 pikë sipas kritereve ekonomike ; …./30 pikë sipas kritereve të nevojës; ..../30 pikë sipas kritereve të prioritetit urban dhe .../10 pikë sipas kriterit inovativ.
Në bazë të kritereve të mësipërme, Komisioni i Vlerësimit e vlerësoi aplikimin tuaj me .... pikë në total.
Projektet fituese, së bashku me pikët përkatëse, janë të përcaktuara më poshtë:

Nr.	Numri i aplikimit	Pikët totale	Vendimi përfundimtar

Sinqerisht

.....

Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve

* Për aplikantët e pranuar.

** Për aplikantët që nuk janë pranuar.

Aneks 6 - Raporti për Përdorimin e Fondit

Raporti mbi Përdorimin e Fondit

Date:.....

Projekti Fitues: .....

Adresa: .....

Nr	Përshkrimi i Punimeve	Njesia	Sasia e planifikuar	Sasia e realizuar	Çmimi	Shuma e plan.	Shuma e realizuar

	TOTALE						

U përgatit nga: .....

(Administratori)

U konfirmua nga:……

.....

.....

.....

(Komisioni i Monitorimit, Bashkia Tiranë)

Aneks 7 – Deklaratë dakortësie mes bashkëpronarëve

DEKLARATË DAKORDËSIE

Në date ……, ne …… (nr bashëpronarëve aplikues) bashëpronarët e godinës me adresë ……. me përfaqësues administratorin e pallatit ……. (emri, mbiemri), të cilët përbejmë …….. % të totalit të kuotave të bashkëpronësisë, biem dakort që:

1. Të autorizojmë administratorin të aplikojë në "Fondin e Komuniteteve".
2. Të lejojmë ndërhyrjen në pronën tonë të përbashkët për sa është përshkruar në projekt idenë e bashkalidhur me këtë aplikim.
3. Do te lëshojmë detyrimin financiar total prej …… (lekësh) në rast se Kominisioni i Vlerësimit të Aplikimit të "Fondit të Komuniteteve" do të na shpallë fitues.
4. Ky detyrim financiar do te ndahet ndërmjet nesh (bashkëpronarëve) me skemen e mëposhtme:

   ……
   ……

Firmat e Bashkëpronarëve:

Emër/ Mbiemër Nr.ID Firmë